VENDIM
Nr.196, datë 28.7.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.3, DATË 19.9.2005 TË KUVENDIT "PËR CAKTIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 21 dhe 55 pika 1 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Deputeti Ilir Rusmali zgjidhet Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të drejtat e Njeriut në vend të deputetit Fatos Beja.

II. Deputeti Gjovalin Prenga kalon nga anëtar i Komisionit për Sigurinë Kombëtare, duke zëvendësuar deputetin Fatos Beja, si anëtar i përhershëm i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

III. Deputeti Engjëll Cara kalon nga anëtar i Komisionit për Integrimin Europian në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

IV. Deputeti Fatmir Mediu zgjidhet anëtar i Komisionit për Politikën e Jashtme.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)